



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 18, datë 20.02.2017

Për

“KALIMIN E VEPRAVE HIDRIKE TË UJËSJELLËS-KANALIZIME, TË AKTIVEVE TË QËNDRUESHME TË PATRUPËZUARA, TRUPËZUARA DHE AKTIVET QARKULLUESE, PËR TË CILAT GËZON TË DREJTËN E PRONËSISË OSE TË DREJTA TË TJERA TË LIGJSHME, NË ADMINISTRIM TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A.”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/ 1.1, shkronja “b”, pika 1/ 1.2, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55 pika 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 115/2014 për “Ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 për “Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”); Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 për “Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar); Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.193/1, datë 07.01.2016 dhe Nr. 193/2 datë 24.02.2016 (i ndryshuar) mbi “Ngritjen e komisioneve për inventarizimin e veprave hidrike të ujësjellës-kanalizime, të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara, trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, për të cilat gëzon të drejtën e pronësisë ose të drejta të tjera të ligjshme, bazuar në VKM-në Nr. 510, datë 10.06.2015 për “Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Kalimin në administrim të Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A. të veprave hidrike të ujësjellës-kanalizime, të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara, trupëzuara dhe aktivet qarkulluese të listuara në Aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilat Bashkia e Tiranës gëzon të drejtën e pronësisë ose të drejta të tjera të ligjshme (në vijim referuar si “**veprat hidrike**”).

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore në lidhje me dorëzimin e veprave hidrike tek “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” Sh.A.
3. Ngarkohet “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” Sh.A, të caktojë një grup ekspertësh të jashtëm që të bëjnë një rivlerësim të veprave hidrike që i kalohen në administrim, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Vlerësimi sipas pikës 3, do të pasqyrohet në rregjistrat e aktiveve të të dy njësive.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit dhe “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” Sh.A..
1. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI